



Viti i VIII-të i Botimit, Nr.2,  
Dhjetor 2017

## INTEGRIMI I TEKNOLOGJISË NË MËSIMDHËNIE TEK NXËNËSIT DISLEKSIKË

**Besmir Kanushi**

Departamenti Inxhinierive, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, Albanian University

**Adresë kontakti:** *bkanushi@gmail.com*

### **Përmbledhje**

Institucionet arsimore po kompletohen/pajisen me laboratorë informatike dhe aksesit në internet po zhvillohet me ritme të shpejta. Mësuesit duhet të aftësohen në përdorimin e kompjuterave dhe të integrojnë teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit në mënyrë efektive në lëndët përkatëse.

Në këtë punim është konsideruar një studim rasti në vështirësinë që mësuesit paraqesin në integrimin e teknologjisë në mësimdhënie tek fëmijët disleksikë. Ai bazohet në vëzhgimet, pyetësorët dhe mendimet e mësuesve.

Në vendin tonë janë ndërtuar qendra multifunksionale për fëmijë me aftësi të veçanta, të cilat në trajtimin e tyre përfshijnë edhe teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit. Ndërkohë, që për shkollat që nuk kanë nxënës disleksikë përdorimi i teknologjisë së informacionit është një proces i cili pasurohet gjatë përdorimit, dhe nuk mund të themi të njëjtën gjë për shkollat që kanë nxënës disleksikë.

**Fjalë çelës:** *TIK, disleksi, mësimdhënie, mjete, softuer*

## INTEGRATION OF TECHNOLOGY IN TEACHING FOR STUDENTS WITH DYSLEXIA

### **Abstract**

Educational institutions are being/completed with computer labs and internet access is developing very fast. Teachers should be enabled to use computers and integrate information and communication technology effectively into relevant subjects.

In this work is considered a case study in the difficulty of the teachers to integrate the technology in learning for the dyslexic children. This study is based on observations, surveys and teacher opinions.

In our country are built multifunctional centers for children with special needs, which use also technology in the treatment of dyslexic children. Meanwhile, for the schools that don't have dyslexic students, the use of information technology is a process that is enriched during time, but we cannot say the same for schools that have dyslexic students.

**Key words:** *TIK, dyslexic, teaching, tools, software*

### **1. HYRJE**

Një mësues dërgoi një shënim në shtëpi me një djalë gjashtëvjeçar. Në letër shkruhej: *Fëmija juaj nuk është në rregull, mos e sillni më në shkollë se është i rrezikshëm për fëmijët e tjerë! Pasi*

*e lexoi nëna buzëqeshi dhe i tha të birit: Në letër shkruhet se je shumë i zoti prandaj nuk është e nevojshme të shkosh më në shkollë.*” Ai nxënës ishte Thomas A. Edison (shpikësi i llambës elektrike).

Ky artikull analizon dijen e disleksisë si një vështirësi leximi midis mësuesve të shkollave të ndryshme dhe disa qendrave multifunkionale në Vlorë dhe Tiranë. Hulumtimi empirik fokusohet në hetimin e ndërjegjësimit të mësuesve në lidhje me disleksinë.

Qëllimi i hulumtimit është për të gjetur nëse mësuesit janë të vetëdijshëm për disleksinë dhe për të kuptuar reagimin e tyre ndaj fëmijëve me disleksi.

Disleksia është paaftësia më e zakonshme e leximit. Pesëmbëdhjetë në njëzet për qind e popullsisë përballen me simptoma të ndryshme të disleksisë, të tilla si: *drejtshkrim i dobët, rrjedhshmëri në lexim dhe vështirësi në të shprehur veten.*

Shpesh mund të ketë talente në fusha të ndryshme të tilla si: arti, dizajni, shkenca kompjuterike, muzikë, shitje dhe mekanikë.

“Qëllimi kryesor i edukimit është krijimi i burrave dhe grave që janë të aftë për të bërë gjëra të reja dhe jo për të përsëritur atë që kanë bërë brezat e tjerë” *Jean Piaget.*

## 2. Çfarë është disleksia (sëmundje apo çrregullim)?

### **Disleksia është:**

- lloj specifik i paaftësisë në të mësuar (1) (paaftësia për ta përpunuar informacionin),
- çrregullim i bazuar në gjuhë (paaftësia e artikulimit të fjalëve),
- vështirësi në dekodimin e fjalës së veçuar (nuk arrijnë të bëjnë lidhjen e fjalëve),
- karakterizohet nga një dobësi e fshehur në vetëdijen fonologjike (mungesë vetëdijeje të tingujve në fjalë),
- një hendek i paparashikuar midis potencialit të të nxënës dhe arritjeve akademike,
- një ndryshim (diferencë) në strukturën dhe funksionin e trurit,
- një vështirësi me aftësitë gjuhësore akademike (në thelb të lexuarit, të shkruarit dhe të shqiptuarit),
- mungesë talenti për përdorimin e gjuhës së printuar,
- një çështje e nivelit të zbutur ose të ashpër. Ka faza të ndryshme, ku problemi për disa është më i lehtë dhe për të tjerë më i theksuar.

### **Disleksia nuk është:**

- një mungesë e inteligjencës ose aftësisë për të mësuar,
- një problem sjellor,
- problem psikologjik,
- problem pamor (disleksikët “nuk i shohin shkronjat praptazi”),
- një sëmundje; nuk ka kurë, një problem balance.

### 2.1 Shkaqet e mundshme për një lexim të varfër

- **Neurologjike:** strukturë/funksion trunor anormal.
- **Gjenetike:** (2) disleksia rrjedh në familje. Është gjetur që disa gjene janë të lidhur me paaftësitë në të lexuar.
- **Instruksional:** mësimet të papërshtatshme do të shkaktojnë probleme me të lexuarit.
- **Disavantazh ekonomik:** ekspozimi i pamjaftueshëm ndaj materialit të printuar dhe leximi i pakët prindëror mund të drejtojë drejt një ambienti të mësuari të papërshtatshëm për fëmijën. Fëmijët normalë do të kenë probleme jo vetëm në të lexuarit, por edhe në fusha të tjera.
- **Motivacioni:** motivimi i ulët në të lexuar çon drejt një performace të varfër. Një mangësi

në aftësitë për të lexuar ndikon në arritje në të gjitha fushat e tjera të edukimit. Nga studimi i kryer rezultoi që disa nxënës me disleksi kanë vështirësi në kapacitetet fonetike d.m.th nuk arrijnë të lidhin simbolet grafike me tingujt që ato përfaqësojnë. Megjithatë ata arrijnë të kuptojnë sinjale të tjera ose simbole komunikimi, si p.sh. shenjat rrugore ose fjalë që kanë një aspekt të veçantë.

Disa nxënës disleksikë tentuan t'i lexonin fjalët nga e djathta në të majtë, të ngatërronin fjalët si dhe të shfaqnin vështirësi të veçanta në njohjen e shkronjave në të cilat ka rëndësi orientimi (p.sh.: p, q b, d). Nxënësit i bëjnë këto tipe gabimesh si në lexim, dhe në shkrim.

**Tabela 1. Gabime leximi të një fëmije disleksik**

|          |         |
|----------|---------|
| Qeni     | Peni    |
| Zhurma   | Zhumra  |
| Arma     | Amra    |
| Gropa    | Gnopa   |
| Ada      | Oda     |
| Bora     | Dora    |
| Kirurg   | Kirurk  |
| Aeroplan | Aroplan |
| Libri    | Lidri   |

### 3. Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie

Bota karakterizohet nga ndryshime të shpejta, një pjesë e të cilave ka ardhur dhe nga zhvillimi i shpejtë i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (3). Arsimi duhet t'u përshtatet ndryshimeve të vazhdueshme të teknologjisë dhe t'i përdorë ato gjerësisht në procesin mësimor. Në epokën e zhvillimit të teknologjisë së informimit dhe komunikimit, përdorimi i kësaj teknologjie gjatë procesit mësimor është bërë një domosdoshmëri për mësuesit, e cila shkon në ndihmë të nxënësit që ai të jetë:

- Përdorues i informacionit teknologjik;
- Kërkues, analizues dhe vlerësues i informacionit;
- Zgjidhës problemesh dhe marrës vendimesh;
- Krijues dhe përdorues efektiv i mjeteve produktive;
- Komunikues, bashkëpunues, publikues dhe prodhues;
- Qytetar i informuar, përgjegjës dhe kontribuues.

Shumë mësues e justifikojnë mungesën e burimeve në klasë, si një formë e teknologjisë së kufizuar, akses i kufizuar, kohë dhe mbështetje e pamjaftueshme teknike. Për mësuesit me nivele të ulëta socio-ekonomike, kjo mund të jetë veçanërisht e vështirë për t'u kapërcyer, shkurtimet gjithnjë e në rritje të buxhetit ofrojnë burime edhe më pak se më parë.

#### 3.1 Mungesa e burimeve

Mungesa e burimeve është e dukshme në katër zona/këndvështrime të ndryshme.

1. **Mungesa e teknologjisë:** Pa harduerët e nevojshëm, softuerë, akses në internet, mësuesit e kanë të vështirë për të integruar teknologjinë.
2. **Akses i pamjaftueshëm:** Mësuesit mund të gjejnë edhe mungesën e aksesit ndaj teknologjisë si një pengesë. Për shembull, edhe pse shkollat shpesh kanë laboratorë kompjuterikë,

mësuesit nuk mund të kenë akses të lehtë në qoftë se ata nuk kanë një shumëllojshmëri të programeve përkatëse dhe një lidhje relativisht të shpejtë të internetit.

3. **Mungesa e kohës:** Integrimi i teknologjisë në një program mësimor mund të jetë me të vërtetë konsumim - kohe. Mësuesit duhet të shpenzojnë orë përpara faqeve të internetit, duke fituar familjaritet me harduerët dhe softuerët dhe të njihen me programe të ndryshme.
4. **Mbështetje e pamjaftueshme teknike:** Mësuesit mbështeten tek teknikët për t'i ndihmuar ata në shfrytëzimin e teknologjive të ndryshme. Prandaj përdorimi i teknologjisë pengohet ose funksionon në një nivel më të ulët, ndërsa mësuesit presin për mbështetje teknike.

### 3.2 Përdorimi i teknologjisë tek fëmijët disleksikë

- I lejon fëmijët disleksikë të kompensojnë mjaft vështirësi të veta.
- I lejon mësuesit të zhvillojnë programin mësimor edhe me subjekte të prekura nga DSA (çrregullimet në të nxënë).
- I lejon prindërit të marrin ndihmë nga instrumente që favorizojnë pavarësinë e fëmijës.

### 3.3 Përparësitë e përdorimit të teknologjisë së informacionit

1. Prania e letrave të shtypura me shkronja të mëdha në tastierë për të mos lodhur memorien e punës.
2. Shkruajtja e çdo teksti në mënyrë grafikisht të lexueshme.
3. Shkruajtja e teksteve me ortografi të saktë në saj të korrigjuesit automatik.
4. Gjetja e informacionit në “magazina”, si: enciklopedi multimediale, internet, etj.
5. Importim i teksteve dhe imazheve me skaner.
6. Shkëmbim i dokumenteve dhe informacionit.
7. Ndërtimi i hartave konceptuale për studim.

### 1.4 Qasja rehabilituese nëpërmjet kompjuterit gjithmonë në avantazh

Ne mund ta kuptojmë më mirë këtë rezultat nëse e krahasojmë vlerën e disa programeve arsimore rehabilituese që kanë karakteristika shumë të ngjashme me vetë lojërat kompjuterike (4) ( p.sh., *Bachi Spaziali* dhe *Sorpasso!* ).

Nga ky krahasim del qartë aspekti lojçak dhe konkurrues, i cili mund të motivojë shumë të rinj me disleksi në ato situata ku ndërhyrja me terapi tradicionale dështon.

### Softuerët specifikë

Për më të vegjlit - *softuerë* të gatshëm:



Fig. 1. *Facilissimo*

**Facilissimo** është një mjedis lojë në një fletë letre/ fletë vizatimi në të cilën përfshihen një sërë aktivitete që nxënësit DAS mund të kryejnë pa pasur nevojë të dinë se si të lexojnë.

**Objekti:** Programi synon të zhvillojë kreativitetin nëpërmjet ushtrimeve të ndryshme duke përfutur nga situata të lojës dhe kanalit vizual.

**Corso di lettura:** Ky softuer mund të përdoret në shërimin e funksioneve të gjuhës që në fund të mësimin me ushtrime të llojeve të ndryshme të kombinuara me lojëra për të krijuar një moment pauze dhe ndryshimi nga angazhimi arsimor i zakonshëm.

**Objektivi:** Rritje e kompetencës leksikore duke futur parakushte për lexim-shkrimin si dhe ushtrimi përmes një fjalori të thjeshtë dhe konkret duke u ndalur veçanërisht tek përemrat vetorë dhe shkronjat e alfabetit.

**Bachi Spaziali** Kemi të bëjmë me një ndërfaqe të bukur dhe tërheqëse të 3 lojërave të ndryshme: pushtuesit, krimbat dhe fluturat dhe një regjim pa grafika për përdoruesit e rritur apo për ata që kanë nevojë për një mjedis të thjeshtuar. Ajo duket si një video-lojë, në të cilën duke rënë poshtë shkronjat, fjalët apo numrat duhet të lexohen dhe të kthehen për të marrë një *feedback* (vizual apo zonor).

**Objektivi:** Inkurajon procesin e të shkruarit/lexuarit dhe familjaritetin me tastierën.

**Cloze** paraqitet një tekst me disa mangësi, pra fjalë të zhdukura, të përcaktuara në mënyrë të rastësishme nga programi në varësi të nivelit të vështirësisë vendosur nga operatori.

**Objektivi:** Të përqendrohet vëmendja e përdoruesit tek mikroelementët e tekstit (ndajfolje, nyja, përemra) dhe pastaj të zhvillohet një kuptim më i saktë i asaj që është e bazuar në zotërimin e makro-komponentëve (emrat, foljet).




Fig. 2. Cloze

**Anafore:** Teksti paraqitet duke theksuar anaforat, p.sh.: ky, kjo, etj. (anafora janë fjalët që i referohen fjalëve të tjera në fjali). Përdoruesi duhet të vendosë se kujt i referohen këto anafora duke zgjedhur nga një listë mundësish që i ofrohet.

**Objektivi:** Të përqendrohet vëmendjen e përdoruesit në gjurmët e tekstit dhe në këtë mënyrë të përmirësojë të kuptuarit e përgjithshëm.

#### 4. AUTONOMIA

Me fjalën autonomi, kur bëhet fjalë për fëmijët disleksikë, kuptojmë “*pavarësinë, lirinë për të vepruar dhe të menduar*”. Për të arritur autonominë formuese arsimore nevojiten: masat e duhura kompensuese; motivim i mirë; mjedis mbështetës. Kompjuteri ofron disa përgjigje për të gjitha nivelet e përmendura më sipër. Tiparet pozitive të kompjuterit përkojnë me vështirësitë e mëdha të fëmijëve disleksikë. **Kompjuteri** (5) është një mundësi e shkëlqyer për njerëzit që jetojnë me disleksi, pasi vendoset si mjet i deleguar duke lejuar përdorimin e plotë të aftësive të paprekura, të tilla si inteligjenca dhe imagjinata.

#### Pajisjet harduerë



Fig. 3. Pajisjet harduerë

### Zgjidhjet me anë të softuerëve

**Word:** (6) programi videoshkruar Word përmban dy opsione (instrumentet: kontrolli ortografik dhe gramatikor dhe korrigjuesi automatik) që rezultojnë shumë efikasë në persona me disortografi. Makina llogaritëse në *Windows*: mund të shërbejë si një ndihmë e jashtëzakonshme në personat më *discalculia*.

**Njohja zanore:** Njohja zanore (*Naturally Speaking Preferred*) ju lejon të shkruani me diktimin dhe nuk prodhon gabime në drejtshkrim.

## 5. Studim Rasti

### Qëllimi

Qëllimi i këtij studimi rasti është për të shqyrtuar nëse mësuesit e shkollave janë të vetëdijshëm për termin e disleksisë. Kjo siguron një kuptim më të mirë të perceptimeve të arsimtarëve në lidhje me disleksinë dhe sa janë të vetëdijshëm për këtë. Një qëllim/ këndvështrim tjetër është për të hetuar vetëdijen e mësuesve për përgjegjësitë e tyre për të ofruar mundësi të barabarta për këta fëmijë.

### Metoda

Një hulumtim cilësor, duke përdorur një pyetësor të hapur të strukturuar, është përdorur për të mbledhur të dhëna rreth ndërgjegjësimit të mësuesve dhe njohurive në lidhje me disleksinë dhe çështjet e saj. Tekstet e siguruar nga anketat u janë nënshtruar analizave tematike.

### Rezultatet

Rezultatet e hulumtimit ndihmuan për të kuptuar ndërgjegjësimin e mësuesve të shkollave në lidhje me disleksinë. Rezultatet e pyetësorit treguan se shumica e mësuesve nuk kishin dëgjuar për disleksinë. Edhe pse pjesa më e madhe e mësuesve kishte keqkuptim ose më saktë informacion të cunguar për disleksinë, më shumë se gjysma prej tyre konsideroi se roli i tyre ishte shumë i rëndësishëm për të siguruar mundësi të barabarta për fëmijët të cilët shfaqin shenja të lehta të kësaj gjendjeje, ose për të bërë punë të diferencuar me ta. Pothuajse të gjithë mësuesit ishin të mendimit se fëmijët disleksikë duhet të trajtohen nga mësues/specialistë për trajtimin e disleksisë në një qendër të veçantë. Detyrën kryesore e kanë prindërit. Fillimisht ata duhet ta pranojnë gjendjen e fëmijës së tyre e më pas të drejtohen në ato qendra ku mund t'u ofrohet trajtim i specializuar.

Tabela 2. Të dhëna nga stafi i mësuesve pjesëmarrës në pyetësor


| Gjinia    |    | Mosha  |         |         | Përvojë pune |        |         |     | Arsimi        |         |
|-----------|----|--------|---------|---------|--------------|--------|---------|-----|---------------|---------|
|           |    | 25– 35 | 36 – 45 | 46 – 56 | 1 – 5        | 6 – 10 | 11 – 25 | >25 | Vetëm i mesëm | I lartë |
| F         | 19 | 6      | 8       | 5       | 2            | 6      | 8       | 3   | 0             | 19      |
| M         | 0  | 0      | 0       | 0       | 0            | 0      | 0       | 0   | 0             | 0       |
| Totali 19 |    | 6      | 8       | 5       | 2            | 6      | 8       | 3   | 0             | 19      |

**Tabela 3. Përgjigjet nga të dhënat e mësuesve**

| Gjinia | Kishin informacion rreth disleksisë | S'kishin informacion rreth disleksisë | Njihnin rrjete teknologjike/softuerë | Kishin punuar me nxënës disleksikë | K i s h i n dëshirë për t'u trajnuar |
|--------|-------------------------------------|---------------------------------------|--------------------------------------|------------------------------------|--------------------------------------|
| F      | 8                                   | 11                                    | 0                                    | 0                                  | 5                                    |
| M      | 0                                   | 0                                     | 0                                    | 0                                  | 0                                    |
| Totali | 8                                   | 11                                    | 0                                    | 0                                  | 5                                    |

**Tabela 4. Rezultatet e pyetësorit**

| Gjinia  | Kishin informacion | S'kishin informacion | Kishin punuar me nxënës disleksikë | Kishin dëshirë për t'u trajnuar | Njihnin mjete teknologjike/softuerë për mësimdhënie |
|---------|--------------------|----------------------|------------------------------------|---------------------------------|-----------------------------------------------------|
| Femra   | 8                  | 11                   | 0                                  | 5                               | 0                                                   |
| Meshkuj | 0                  | 0                    | 0                                  | 0                               | 0                                                   |

**Fig. 4. Rezultate të pyetësorit**

### Përfundime

Shqisa e të dëgjuarit është përdorur në të dëgjuarit e asaj çfarë thotë mësuesi. Fëmija disleksik mund të provojë vështirësi në njërin nga këto shqisa. Vizioni i fëmijës mund të ndikohet nga vështirësitë në të ndjekurit e fjalëve, përpunimin vizual ose në të parët e fjalëve që bëhen të paqarta ose lëvizin përreth.

Të dëgjuarit e fëmijës mund të jetë i kënaqshëm në një test dëgjimi, por memoria dëgjimore ose përpunimi dëgjimor mund të jetë i dobët. Për shumicën e fëmijëve disleksikë është menduar se ata janë të paaftë mendërisht. Në çdo shkollë, në çdo javë të vitit një fëmijë disleksik provon dështim në një sasi shumë të madhe.

Ajo çfarë unë sugjeroj është pak terapi kognitive nga mësuesit dhe nëse është e mundur, bashkë me prindërit.

Objekti i detyrës së shumë shkollave është ndërtimi i aftësive të të lexuarit, nëpërmjet ndihmës me praktikën e nevojshme për trajtimin e çrregullimeve të ndryshme si ai i disleksisë, i vëmendjes ose paaftësi të tjera në të mësuar.

Nevojë primare për t'u ardhur në ndihmë fëmijëve me çrregullime në të nxënë (probleme në të lexuar, shqiptuar, folur, shkruar) është ngritja e qendrave të specializuara multidisciplinore me

metoda të mësuarit efektive shumë-shqisore. Qendra të tilla duhet të kenë të përfshirë në stafin e tyre njerëz të specializuar, si: mësues të specializuar, psikologë, pediatër, logopedë, etj., të cilët duke bashkërenduar punën e tyre, do të jenë të aftë të trajtojnë dhe rikuperojnë apo zbusin sadopak këto çrregullime tek fëmijët.

Gjithashtu, aplikimi dhe përdorimi i mjeteve të ndryshme teknologjike dhe në veçanti i softuerëve aplikativë është një mënyrë shumë efikase për arritjen e rezultateve të duhura për trajtimin dhe rikuperimin e gjendjes së këtyre fëmijëve.

### Referenca

1. The term dyslexia can refer to an anomalous approach to processing information. Silverman, L. (2000). "The two-edged sword of compensation: How the gifted cope with learning disabilities", in *Uniquely gifted: Identifying and meeting the needs of twice exceptional learners*, Avocus Publishing Inc., pp. 153–159.
2. Grigorenko, Elena L. (2001). "Developmental Dyslexia: An Update on Genes, Brains, and Environments". *Journal of Child Psychology and Psychiatry*. 42 (1): 91–125.
3. Faudel, H 2008, "Teachers and trainers in vocational education and training reform in the new and future member states", *International Journal of Vocational Education and Training*, vol. 16, no. 2, pp. 39-46.
4. National ICT competency standard (NICS) for teachers. (Tetor 2006)
5. <http://www.innovativeteachertoolkit.com/resources.html>
6. Samitit Botëror (2003). Mbi Shoqërinë e Informacionit, Gjenevë. Burimi online <http://www.wsisgeneva2003.org/home.html>